



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Procesverbal

nga takimi publik me qytetarë i mbajtur më 30 qershor 2025

Takimi filloi në orën 10.20

Takimin publik e hapi dhe e kryesoi z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës. Në takim ishin të pranishëm një numër i qytetarëve (34 pjesëmarrës); Nënkryetaria e Komunës, Drejtorët e Drejtorive të Administratës së Komunës, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësues të OJQ-ve dhe mediat.

Tema:

Realizimi i projekteve dhe aktiviteteve tjera të parapara në gjashtëmujorin e parë të vitit 2025, projektet dhe aktivitetet që janë në proces, si dhe ato të planifikuara për realizim.

z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, e respektuara Nënkryetare, Drejtor të Drejtorive, të respektuar qytetarë, përfaqësues të KFOR-it, media, ju përshëndes të gjithëve, në radhë të parë ju falënderoj që keni gjetur kohën e çmuar tuajën sot që jemi bashkë në këtë prezantim të punës, të raportit të punës të Kryetarit të Komunës për periudhën gjashtë mujorore të këtij viti. Sigurisht që ndërlihet viti me vit me një varg projektesh të ndryshme qoftë në kuptimin e vazhdimësisë tyre qoftë në kuptim të inicimit të procedurave të reja për projektet që janë duke u zhvilluar gjithandej Komunës sonë. Prandaj po bëj përpjekje të paraqes në pika të shkurtra të gjitha ato punë dhe projekte të cilat janë duke u zhvilluar apo që kanë filluar gjatë këtij gjashtë mujori, duke shpresuar se do t'i përmbyllim suksesshëm edhe këtë vit sikurse vitet tjera. Atëherë të fillojmë sipas Drejtorive;

DREJTORIA E ADMINISTRATËS

Në Sektorin e Gjendjes Civile në Podujevë, në zyrat e Gjendjes Civile në lokalitete dhe në E-Kioska sipas kërkesave të qytetarëve janë lëshuar gjithsej: 32483 certifikata të ndryshme të gjendjes civile. Gjatë kësaj periudhe kohore ku kjo është vërejtur edhe nga ana e qytetarëve kemi një shërbim efikas dhe ajo që është shumë e rëndësishme është fakti që qytetarët tanë tashmë nuk kanë nevojë të presin me orë të tëra për të kryer një shërbim, sepse këto punë dhe shërbime janë jashtëzakonisht efikase. Me qëllim të përmbushjes së këtyre punëve dhe shërbimeve kjo Drejtoria ka marrë dy vetura të reja me qira për nevojat e administratës komunale, për faktin se pjesa dërmuese e automjeteve që i kemi janë bukur shumë të vjetruara dhe nganjëherë më shumë po kushton mirëmbajtja e tyre sesa kostoja e marrjes me qira. Këto dy makina faktikisht janë marrë me qira dhe ne nuk kemi asnjë obligim ndaj tyre përveç qeras dhe shpenzimit të derivateve, ndërsa gjitha të tjerat i mbulon kompania.

DREJTORIA E BUXHETIT DHE FINANCAVE

Në kuadër të kësaj Drejtorie është planifikuar Korniza Afatmesme Buxhetore 2026-2028 e Komunës së Podujevës, kjo kornizë buxhetore është me buxhetin më të madh në historinë e Komunës së Podujevës, ku për vitin 2026 planifikohet buxhet në vlerë 34,778,954.00 euro ndërsa në vitin 2028 arrin shumën prej 38,453,975.00 euro, kjo duke marrë parasysh edhe faktin nga granti qeveritar, por edhe të hyrat vetanake që planifikohet të realizohen nga ana e komunës.

Janë realizuar të hyra vetenake në periudhën Janar-Qershor afër 1.1 milion euro., shumë e cila do të na ndihmoj në përmbylljen e shumë projekteve të cilat i kemi planifikuar për realizim.

Është bërë bartja e të hyrave vetenake, në vlerë 890,000.00 euro, shumë e cila është bërë pjesë e shumë projekteve që janë duke u realizuar.

Gjatë kësaj periudhe janë regjistruar në sistemin e tatimit në pronë 650 objekte të reja , që do të ketë ndikim pozitiv në rritjen e të hyrave vetenake të komunës. Lidhur me këtë kur ne kemi marr qeverisjen kemi pas një numër jashtëzakonisht të madh të objekteve të cilat fare nuk kanë qenë të regjistruara dhe nuk kanë qenë pjesë e participimit të hyrave vetenake dhe në këtë aspekt është bërë një punë e jashtëzakonshme e Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave.

DREJTORIA E ARSIMIT

Drejtoria e Arsimit po ashtu është në proces të realizimit të një varg punëve dhe projekteve, si vijon: Fillimi i punimeve në projektin me masa efçente në 4 shkolla: Shkolla e Mesme Ekonomike “Isa Boletini” Shkolla Fillore “Hamit Sejdiu” në Pakashticë, Shkolla Fillore “Ali Ajeti” në Lladoc, dhe Shkolla Fillore “Shefki Kuleta” në Terrnavë, vlera e projektit 698,728.80 euro.

Fillimi i ndërtimit të shkollës “Nuhi Gashi” në Bradash, vlera e projektit 624,249.74 euro.

Ndërtimi i shkollës “Jetullah Gashi” në Doberdol, aktualisht është në procedurë të prokurimit. Vlera e parashikuar është 550,000 euro, sa kam informacioneve për këtë projekt ka një ankesë dhe jemi në pritje që ditëve në vijim të nënshkruajmë kontratën për fillimin e punimeve. Në mënyrë që fëmijët të mos kenë telashe ne kemi planifikuar që nga data një shtatori t’iu sigurohet transporti këtyre fëmijëve sepse deri sa të ndërtohet objekti shkollorë jemi të obliguar që fëmijëve t’u sigurohet transporti dhe mësimi në shkollën e fshatit Bajçinë.

Fillimi i procedurave për ndërtimin e sallës së sporteve në shkollën “Shaban Shala” në Podujevë, në bashkëfinancim me MASHTI-n, vlera e përafërt e projektit është 350,000 euro.

Fillimi i procedurave për ndërtimin e sallës së sporteve në shkollën “Kongresi i Manastirit” në Gllamnik, në bashkëfinancim me MZHR-në, vlera e projektit është 350,000 euro.

Ndërtimi i kuzhinës qendrore aktualisht është në procedurë të prokurimit. Vlera e parashikuar është 700,000 euro. Për Çerdhet që janë duke funksionuar dhe për fëmijët e nivelit të ciklit të ulët në shkolla u sigurohet një lloj shujte dhe po planifikojmë që me këtë kuzhinë që do të krijohet si institucion i veçantë të bëhet sigurimi i shujtës për të gjitha çerdhet por edhe për fëmijët në nivel të arsimit të ultë.

Ndërtimi i aneksit të shkollës “Naum Veqilharxhi” në Llapashticë të Epërme, aktualisht është në procedurë të prokurimit, vlera e parashikuar është 50,000 euro.

Furnizim me kabinete shkollore, vlera financiare është 145,599 euro. Ky projekt është në fazën e realizimit.

Furnizim me material shkollor aktualisht është në procedurë të prokurimit, vlera e parashikuar është 30,000 euro.

Furnizim me inventar për çerdhe aktualisht është në procedurë të prokurimit, vlera e parashikuar është 120,000 euro. Planifikohet që me 1 shtator të fillojnë punën edhe dy çerdhe të reja, nuk jam i sigurt nëse do të arrijmë Çerdhen e tretë në qytet ta aktivizojmë me 1 shtator. Është fjala për Çerdhet në fshatrat Kërpimeh dhe Batllavë Furnizim dhe mirëmbajtje të kamerave shkollore, vlera financiare është 10,000 euro. Kontrata është nënshkruar dhe aktualisht është në fazën e realizimit.

Furnizim me kabinete të shkencave të elektroteknikës për shkollën “Fan S. Noli” në Podujevë, në bashkëfinancim me IOM-in, vlera financiare është 12,964 euro. Ky projekt është në fazën e realizimit.

Furnizimi me kabinete të shkencave natyrore në shkollën “Shefki Kuleta” në Bellopojë, në vlerë financiare 21,940 euro, projekt i realizuar me KFOR-in Turk.

DREJTORIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE

Janë subvencionuar 500 qytetarë me sëmundje kronike për mbulimin e shpenzimeve për barna.

Janë subvencionuar me 20 mijë euro OJQ-t si Hendikosi, Autizmi, dhe OFAP të cilat merren me trajtimin e personave me nevoja të veçanta.

Projekte të realizuara dhe në proces

Furnizim me rëntgen të ri për shërbimin e radiologjisë në QKMF.

Furnizim me 20 bombola oksigjeni (50 litra) për sistemin qendror në urgjencën e re.

Furnizim me EKG për nevoja të shërbimeve në qendër dhe në teren.

Inventarizim dhe pajisje e Dhomës për Edukim dhe Promovim Shëndetësor në maternitet, investim nga UNICEF, AQH dhe Ministria e Shëndetësisë.

Furnizim me 35 kompjuterë të rinj për nevoja të Sistemit Informativ Shëndetësor nga Ministria e Shëndetësisë.

Në fazën e nënshkrimit: projekti për renovim dhe krijim hapësirash të reja për infuzione.

Në fazën e inicimit: projekt furnizimi me aparatura laboratorike (hematologjike dhe biokimike).

Statistika të vizitave dhe shërbimeve

Nr. i vizitave në mjekësinë familjare: 109,385 (84,670 në qendër dhe 24,715 në teren)

Nr. i vizitave në urgjencë: 20,072

Nr. i vizitave specialistike: 3,846

Nr. i vizitave stomatologjike: 3,084 (2,363 në qendër dhe 721 në teren)

Nr. i pacientëve që kanë kryer analiza laboratorike: 11,385 (10,059 në qendër dhe 1,326 në teren)

Nr. i vizitave shtëpiake të Kujdesit Paliativ: 5,075, ky është një shërbim i ri i cili është duke u ndihmuar shumë pacientëve dhe ka qenë prej shërbimeve më të mirëpritura nga qytetarët dhe ata të cilët kanë nevojë për këtë shërbim

Nr. i pacientëve që kanë kryer shërbime radiologjike: 8,393

Nr. i fëmijëve të vaksinuar: 5,223

Nr. i nxënësve të vaksinuar: 2,460

Nr. i vizitave sistematike të fëmijëve në çerdhe publike: 266

Nr. i vizitave sistematike të nxënësve në shkolla: 2,754 (klasa e parë, e pestë dhe e nëntë)

Nr. i vizitave shtëpiake të grave shtatzëna dhe fëmijëve 0-3 vjeç: 617

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT URBAN DHE MBROJTJES SË MJEDISIT

Ndërtimi i rrugës te stacioni i trenit me infrastrukturë përcjellëse me gjatësi 950 m, tashmë kemi një kontratë të nënshkruar nga operatori dhe presim së shpejti për fillimin e punimeve në këtë infrastrukturë

Ndërtimi, zgjerimi dhe rehabilitimi i rrugës së tranzitit Podujevë-Merdar me gjatësi 950 m, tashmë ka filluar së realizuari

Rikonstruimi dhe rehabilitimi i rrugës "Dëshmorët Babatinca" me gjatësi 1,245 m, në proces

Asfaltimi i rrugëve në fshatrat Shajkoc, Sfeçël, Surkish dhe Dumosh me gjatësi 1,465 m, në proces

Asfaltimi i rrugëve në fshatrat Dumnicë dhe Llaushë me gjatësi 1,322 m

Asfaltimi i rrugëve në fshatrat Gllamnik, Siboc, Sallabajë, Lupç i Poshtëm, Lluzhan me gjatësi 1,835 m

Asfaltimi i rrugëve në fshatrat Halabak, Bellopojë, Gërdoc dhe Tërnavë me gjatësi 1,721 m

Asfaltimi i rrugëve në fshatrat Metehi, Revuç, Zakut, Kërpimeh, Pakashticë dhe Dobratin me gjatësi 2,775 m

Asfaltimi i rrugëve në fshatrat Bërvenik, Brain dhe Orllan me gjatësi 1,094 m

Në procedurë të prokurimit:

Asfaltimi i rrugëve në fshatrat Bajqinë, Bradash, Dobërdol, Katunisht dhe Peran me gjatësi 1,658 m

Asfaltimi i rrugëve në fshatrat Shtedim, Miroc, Livadicë dhe Balloc me gjatësi 1,006 m

Asfaltimi i rrugëve në fshatrat Batllavë, Dyz, Herticë dhe Lladoc me gjatësi 1,777 m

Asfaltimi i rrugëve në fshatrat Buricë, Majac, Konushec, Godishnjak, Lluga dhe Popovë me gjatësi 1,443 m

Asfaltimi i rrugëve në fshatrat Llapashticë, Obrançë, Letanc dhe Penuhë me gjatësi 1,822 m

Gjithsej: 21,1 km

Ndërsa Projektet dyvjeçare

Asfaltimi i rrugëve në Qytet 2.4 km; Asfaltimi i rrugëve në fshatrat Dumnicë, Livadicë, Llaushë me gjatësi 2,6 km; Asfaltimi i rrugëve në fshatrat Balloc, Shtedim me gjatësi 2,7 km; Asfaltimi i rrugëve në fshatrat Turuqicë dhe Herticë me gjatësi 2,7 km; Zgjerimi, ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës "Xhemail Mustafa" me gjatësi 2,4 km.

Ndërtimi i rrugës lidhëse nga magjistranja Podujevë-Prishtinë deri në rrugën Vëllezërit Frashëri me gjatësi 1,255 m.

Gjithsej: 14,2 km

Këtë vit falë bashkëpunimit të mirë që kemi pas me Nivelin qendror kemi arritur të realizojmë një numër të projekteve:

Memorandumet me Ministrinë e Infrastrukturës

Riasfaltimi dhe rikonstruimi i rrugës "28 Nëntori" me gjatësi 1,600 m, vlera 1,080,000 €, buxheti 2025: 180,000 €, për dy vitet e ardhshme: 900,000 €.

Riasfaltimi dhe rikonstruimi i rrugës "Podujevë-Letanc" me gjatësi 2,000 m, vlera 965,000 €, buxheti 2025: 165,000 €, për dy vitet e ardhshme: 800,000 €.

Në këto dy rrugët e lartëcekura do të trajtohet edhe ujësjellësi, trotuari, gjelbërimi, pra do të jenë rrugë të ndërtuara sipas standardeve aktuale të cilat kërkohen për një rrugë të mirëfilltë.

Asfaltimi i rrugës "Llapashticë-Popovë" me gjatësi 7,400 m, vlera 1,624,500 €, buxheti 2025: 224,500 €, për dy vitet e ardhshme: 1,400,000 €.

Rikonstruimi dhe asfaltimi i rrugëve në qytet: “Bahri Fazliu, Agron Rrahmani, Ali Ajeti, 19 Qershori, Bedri Bajrami” (gjatësia totale 1,770 m), dhe ndërtimi i urës mbi lumin Llap, vlera 1,434,000 €, buxheti 2025: 300,000 me Memorandum me Ministrinë Infrastrukturës, ndërsa , për dy vitet e ardhshme: 1,134,000 €. Bëhet fjalë për urën e cila do të lidhë rrugën e re përgjatë brezit të lumit Llap, duke vazhduar deri te Rrethi i Shqiponjës.

Ndërtimi i rrugës Orllan-Rakinicë dhe “Rubiku” në Orllan (5,030 m), plus trotuari pranë urës në Orllan (300 m), vlera 983,400 €, buxheti 2025: 200,000 €, për dy vitet e ardhshme: 683,400 €, Komuna kontribuon 100,000 €. Ju sigurisht që jeni në dijeni që nxënësit e asaj pjese kanë pas jashtëzakonisht telashe të mëdha të qarkullimit në urën e Orllanit mbi Liqen, pra planifikohet që ura dhe rruga të zgjerohet me trotuar që fëmijët të kenë mundësi për të lëvizë lirshëm në atë segment rrugor.

Ndërtimi i rrugëve Lluga-Bellopojë dhe Siboc-Dumosh (2,600 m) vlera 531,500 €, buxheti 2025: 100,000 €, për dy vitet e ardhshme: 200,000 €, Komuna kontribuon 231,500 €. Këtu është fjala e segmentit rrugor që lidhet nga rruga e e Rudarëve deri te trafoja në fshatin Bellopojë, sepse atje janë komplet bizneset, afarizmi, bujqit të cilët e frekuentojnë shumë atë rrugë.

Ndërtimi i rrugëve në fshatrat Sylevicë dhe Tërnavicë (6,000 m), vlera 774,000 €, buxheti 2025: 100,000 €, për dy vitet e ardhshme: 300,000 €, Komuna kontribuon 231,500 €.

Nga kjo që po shohim ato rrugë që kanë gjatësi të madhe janë gati të përmbyllen brenda viteve 2025 dhe 2026. Na mbeten një numër i rrugëve që kanë gjatësi shumë më të vogël dhe më lehtë të përballohen. Nuk do të ishte e mundur të bëhen të gjitha këto po mos të ishte ndihma e jashtëzakonshme që kemi marrë nga Ministria e Infrastrukturës që na kanë ndihmuar me një varg projektesh të mëdha.

DREJTORIA PËR PRONË, KADASTËR DHE GJEODEZI

Gjatë periudhës janar-qershor 2025, në Drejtorinë e Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë janë pranuar dhe shqyrtuar 4,851 kërkesa të përgjithshme të pranuar, prej tyre janë aprovuar 4,647; Anuluar: 111; Në procedurë: 93

Shkalla e aprovimit: 95.8%

Regjistrimi i pronës dhe shërbime të lidhura;

Regjistrimi i bartjes së pronësisë: 992 kërkesa

Ndarje, bashkim, legalizim, ri-rregullim njësisish kadastrale: 409 kërkesa

Regjistrim dhe çregjistrim hipotekash: 71 kërkesa – 100% të aprovuar

Kërkesa për korrigjim të dhënave personale: 247 kërkesa – të gjitha të përpunuara

Çertifikata pronësie, plane, koordinata, vërtetime të ndryshme: 3,011 kërkesa

Nëse e marrim me përqindje rezulton se kemi një shkallë relativisht të lartë të zgjedhjes së këtyre lëndëve.

DREJTORIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT

Gjatë periudhës janar-qershor janë realizuar dhe janë në proces të realizimit projektet si në vijim:

Kanë filluar punimet në Pishinën gjysmë olimpikë në vlerë 4 milionë euro, projekt i cili është në bashkë financim në mes Komunës dhe Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit.

Janë në përfundim punimet e aneks-it të Administratës dhe rinovimin e hapësirave ekzistuese të Teatrit “Avdush Hasani” në vlerë 292,520.20, është një projekt në realizim dhe është duke marrë një pamje të bukur ajo pjesë, sepse ka pas një pamje relativisht të shëmtuar.

Është nënshkruar kontraktimi i shërbimeve për shënimin e aktiviteteve kulturore dhe përcjelljen mediatike të punëve të Komunës së Podujevës në vlerë 49,996.00 euro

Kanë filluar punimet në ndërtimin e shtatores dhe rregullimin e hapësirës tek obelisku “Afrim Zhitia” në Lluga, vlera e projektit rreth 200 mijë euro, projekt që financohet nga Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit

Jemi në fazën finale të punimeve në Qendrën Multifunkionale në vlerë rreth 1 milion euro, presim që në muajin shtator do ta kemi të gatshëm për rininë tonë.

Janë subvencionuar 20 OJQ me projekte në fushën e Kulturës dhe Rinisë, shuma totale: 37,700.00 euro

Kemi inicuar procedurën për ndërtimin e mbulojës dhe vendosjen e ndriçimit në stadiumin “Zahir Pajazit” në qytet, është një projekt në vlerë prej 2 milion euro dhe shpresojmë të na ndihmoj Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit.

Subvencione në fushën e sportit në mbështetje të klubeve sportive, shkollave të futbollit dhe individëve të suksesshëm në vlerë 56,550 euro.

Rregullim i shtigjeve për vrapim me material të gomës në parkun e Pishave në gjatësi prej 1km në vlerë 120 mijë euro.

Ndërtimi i fushës së futbollit në fshatin Peran, projekt i përmbyllur.

Ndërtimi i fushës së futbollit në fshatin Siboc, projekt i përmbyllur.

Vendosja e rrethojës dhe ndriçim i terrenit sportiv në fshatin Sfeçël

Vendosja e rrethojës dhe ndriçim i terrenit sportiv në fshatin Surkish
 Rrethoja dhe ndriçimi i terrenit sportiv në lagjen e Brecalive në qytet
 Ndërtim i terrenit sportiv me bari sintetik në fshatin Bellopojë
 Ndërtimi, rrethoja dhe ndriçimi i fushës së tenisit në parkun e Mançesterit
 Rregullimi i hapësirave në dy kate në objektin e palestrës për sportet marciale
 Ndërtimi dhe rrethimi i terrenit sportiv në fshatin Gërdoc
 Ndërtimi dhe rrethim i terrenit sportiv me bari sintetik në fshatin Kaqybeg
 Ndërtimi i fushës së futbollit me bari sintetik në fshatin Obrançë
 Biblioteka e Qytetit në Podujevë gjatë kësaj periudhe nga Drejtoria e Kulturës është pasuruar me gjithsej 236 tituj me 1834 ekzemplarë.

DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE MBROJTJES DHE SHPËTIMIT

Projektet e realizuara dhe në proces të realizimit:

Ndërtimi i trotuareve: Janë ndërtuar rreth 5 kilometra trotuare.

Hartimi i projektit për rregullimin e lumenjve: Në procedurë të prokurimit.

Riparimi i rrugëve të asfaltuara: Në procedurë të prokurimit.

Ndërtimi i ndriçimit publik: Në procedurë të prokurimit.

Rregullimi i infrastrukturës së varrezave të qytetit: Në procedurë të prokurimit. Në këtë segment kemi pas një çalim dhe është mirë t'u thuhet qytetarëve dhe të jenë në dijeni për çalimin për arsye se komuniteti i asaj pjese atje ku atë pronë e kemi shpronësuar për nevoja të varrezave të qytetit patën parashtruar kërkesë që ne të sigurojmë një pronë tjetër me madhësi afërsisht sa të saj për të zgjedh problemin e varrezave dhe si duket nuk e patën shumë me seriozitet por neve na prolonguan punën, prandaj duke pas parasysh jo seriozitetin në raport me autoritetin komunal ne kemi vendosur që projekti të vazhdoj aty ku ka mbetur dhe besoj se së shpejti do të filloj procesi i punëve për realizimin e këtij projekti. E dimë që gjendja e varrezave në qytet është e keqe për shkak të mungesës së hapësirës dhe po shpresojmë se së shpejti do të hapet procedura dhe të zgjidhet ky problem.

Ndërtimi i kanalizimit në fshatrat Lluzhan, Lupq dhe Gërdoc-Lluzhan: Janë ndërtuar 1500 metra kolektor dhe 2361 metra kanalizim fekal.

Rregullimi i rrugëve me zhavor: Janë ndërtuar 30 kilometra rrugë.

Ndërtimi i urave: Në procedurë të prokurimit.

Ndërtimi i rrugëve me kubëza: Janë në ndërtim 70 rrugë të shkurtra, rreth 4 kilometra në total.

Mirëmbajtja dimrore dhe verore e rrugëve: Rrugët janë pastruar sipas kontratës dhe orarit të paracaktuar, me intervenime sipas kërkesave.

Mirëmbajtja e infrastrukturës publike (kanalizim fekal dhe atmosferik): Janë pastruar 65 puseta dhe është ndërhyrë në 1900 metra deblokim.

Mirëmbajtja e lumenjve: Janë pastruar dhe rregulluar 700 metra në lumin "Dumnica" dhe 1200 metra në Prrocka ne Siboc.

Furnizimi me drunjë dekorativ: Janë mbjellë 1850 drunjë dekorativ në qytet dhe fshatra.

Është nënshkruar kontrata për trajtimin e qenve endacak: Janë trajtuar 91 qen endacakë.

Furnizimi me lule: Janë mbjellë 19,000 lule në qytet dhe fshatra.

Mirëmbajtja e ndriçimit publik: Janë ndërruar 2210 trupa ndriçues të dëmtuar, është intervenuar në 69 raste në kutinë shpërndarëse dhe është montuar 1860 metra kabëll.

Mirëmbajtja e trotuareve: Janë zëvendësuar 540 metra katrorë kubëza, janë ndërruar 220 metra skajore, 545 metra katrorë kubëza dhe 84 metra parmak të urave.

Rregullimi i rrugëve: Në procedurë të prokurimit.

Hapësirat publike (shfrytëzim afatshkurtër sezonal): Janë shqyrtuar 39 kërkesa.

Dekorimi i sheshit të qytetit për festat e fundvitit: Në procedurë të prokurimit.

Intervenimet e zjarrfikësve: Është ndërhyrë në 171 raste.

Vendosja e shenjësimeve horizontale dhe vertikale: Në procedurë të prokurimit.

DREJTORIA E BUJQËSISË PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Sektori i pemëtarisë:

Është bërë përzgjedhja e 10 fermerëve të cilët do të përkrahen me nga 1100 euro subvencion në formë të pagesave direkte për blerjen e fidaneve të mjedrrës;

Është bërë përzgjedhja e 15 fermerëve të cilët do të përkrahen me nga 700 euro subvencion në formë të pagesave direkte, për blerjen e fidanëve të feferonave ;

Janë në proces të përzgjedhjes 25 fermerë për t'u përkrahur me spërkatëse 400l;

Janë në proces të përzgjedhjes 20 fermerë t'u përkrahur me gërshërë për krasitje me bateri.

Sektori i perimtarisë

Janë iniciuar procedurat në prokurim për projektin e përkrahjes së fermerëve me serra të këtyre llojeve: Serra 50 m2 134 fermerë, Serra 500 m2 10 fermerë dhe Serra 1000 m2 5 fermerë.

Sektori i bletarisë

Është bërë përkrahja e 15 fermerëve me nga një Duplikator 120 l.

Sektori i blegtorisë

Janë iniciuar procedurat e prokurimit, ku planifikohet të bëhet ndarja e 162 mëshqerrave barrëse. Këtu kemi pas një shpallje publike dhe si rezultat është ofruar një çmim enorm i lartë dhe ishte vetëm një operator. Në këtë rast kemi qenë të detyruar ta anulojmë atë proces të prokurimit dhe ta përsëritim shpalljen, e cila tani më është në proces të prokurimit, është afati më i shkurtër kohor dhe jemi në pritje të një çmimi më të arsyeshëm.

10 Laktofriz 300 lt dhe

5 Mikser për përzierje të ushqimit voluminoz të kafshëve.

Sektori i shpezëtarisë

Janë në proces të përzgjedhjes fermerët të cilët do të përkrahen me: 4 Printer për vulosjen e vezëve.

Janë të hapura ftesat publike për këtë projekt , përmes të cilit planifikohet të bëhet përkrahja e fermerëve si në vijim: Freza dheu 1.85 – 40 copë, Pllug 2 rendor - 15 copë, Mbledhëse bari luledielli- 20 copë

Motokultivator me frezë 75 cm- 25 copë , Shpërndarëse plehu 350 l me kardan-20 copë, Makinë mjelëse për dy lopë-27 copë

Projektet në realizim në bashkëpunim me organizata:

Care International në bashkëpunim me Komunën e Podujevës është duke e zbatuar projektin me temën “Avancimi dhe Përfshirja e Agrobizneseve të Grave në Kosovë (AKWA). Projekti është në fazën e vlerësimit/ përzgjedhjes së përfitueseve. Në kuadër të këtij projekti do të përkrahen gra 24 fermere me këto pajisje:

Pajisje për bletari; Pajisje për përpunimin e qumështit; Motokultivatorë; Serra 50m².

Ka përfunduar me suksese aplikimi për Subvencione/Pagesa direkte, ku në këtë vit kanë aplikuar 2259 fermerë nga Komuna e Podujevës, është fjala për Ministrinë e Bujqësisë.

DREJTORIA E INSPEKSIONIT

Punët dhe aktivitete e DI:

Ndalimi i ndërtimeve pa leje

Gjatë periudhës Janar-Qershor 2025 janë shqiptuar 38 gjoba mandatore nga sektorë të ndryshëm si: Njësia e Shërbimeve Komunale, Tregut, Ndërtimit, Mbrojtjes së Mjedisit dhe e Komunikacionit.

Janë realizuar 605 inspektime në sektorë të ndryshëm gjatë kësaj periudhe

43 Kontrollë të përbashkëta me Policinë e Kosovës

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK

Punët dhe projektet:

Zona Industriale - jemi para lidhjes së kontratës. Ky projekt është në bashkëfinancim me Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë në vlerë 4 milionë eurosh, projekt i cili është zvarritur relativisht shumë dhe duket se në këtë fazë ka pas disa probleme në kuptim të procedurave tenderuese dhe si rezultat i këtyre ngecjeve kemi zvarritje në realizimin e këtij projekti por po shpresojmë që shpejt do të deblokohet si proces. Ndërtimi i Tregut të Gjellbër po vazhdon sipas planifikimeve dhe presim që ky projekt të realizohet deri në vjeshtë dhe do të jetë në dispozicion për përdorim. Tregu po ndërtohet në bashkëpunim me Ministrinë e Zhvillimit Rajonal në vlerë afër 1.5 milionë eurosh.

Është publikuar thirrja publike për “Ngritjen dhe Zhvillimin e Bizneseve” (mbështetje me pajisje pune) me makineri në rrobaqepësi, mekanikë, pastičeri dhe vegla pune, ku pritet të jenë përfitues afër 200 biznese lokale. Në kuadër të fushës së turizmit, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik ka filluar projektin për rregullimin e hapësirave publike në fshatrat Kerpimeh, Sfecël, Llapashticë dhe Dumnicë, projekt i cili ka pas një varg ngejcesh tanimë fatmirësisht është deblokuar dhe ka filluar punën në Kërpimeh dhe atë pjesë do ta kthejmë në një park të gjellbëruar për nevoja të qytetarëve të asaj pjese. Po e njëjta gjë do të vazhdoj në Bajčinë në hapësirën e ish kooperativës bujqësore sikurse edhe në Dumnicë në hapësirën e ish kooperativës bujqësore. Në sektorin e regjistrimit të bizneseve, gjatë kësaj periudhe janë regjistruar 201 biznese të reja dhe janë ofruar informata për afër 500 biznese për ndryshimet sipas kërkesave të bizneseve lokale.

Këto janë disa prej punëve, ndoshta ndonjë edhe mund ta kemi harruar, por besoj se nuk kemi shtuar. Për nga projektet kemi edhe dyvjeçare, ndoshta ka edhe të tilla tri vjeçare. Ajo që është shumë e rëndësishme është fakti se jemi prej komunave që kemi një numër të madh të investimeve që janë duke u bërë çoftë investime nga niveli lokal, por fatmirësisht kemi edhe një varg të projekteve që po na ndihmohet dhe po financohen nga Niveli qendror, apo në bashkëfinancim me Nivelin qendror, por jo vetëm sepse ka projekte ku po marrin pjesë edhe donatorë të ndryshëm të cilët vërtet po na lehtësojnë shumë punën tonë. Tashmë koha është duke marr

mirë dhe projektet janë duke ecur mirë dhe besoj se deri në fund të vitit edhe do ta shfrytëzojmë buxhetin sipas planit buxhetor, nuk do të metët suficit. Ajo që mund ta ndaj si shqetësim me ju është fakti i kontratave kolektive ku kanë qenë të nënshkruara nga ish qeveritë dhe të njëjtat janë duke ma shkaktuar relativisht shumë shqetësime për arsye se përmes masave përmbartimore është duke ndodhur shpesh që po na tërheqin mjetet buxhetore dhe ajo që është më e keqja është se po na heqin mjetet buxhetore edhe nga projektet për të arritur t'i realizojnë obligimet ndaj punëtorëve arsimor. Në këtë vit na kanë marrë afër dy milion euro buxhet të Komunës dhe në disa projekte na kanë shkaktua vështirësi në përmbylljen e tyre. Jemi duke bërë ç'është e mundur edhe me Drejtorinë e Buxhetit dhe Financave të bëjmë kalkulimet në mënyrë që kur po bëhet tërheqja e mjeteve të merren prej disa kodeve buxhetore që nuk na sjellin shumë shqetësime por nganjëherë nuk po ndodhë ashtu si ne duam, por sidoqoftë jemi duke bërë përpjekje që të menaxhojmë në mënyrën sa më të mirë të mundshme.

Unë ju falënderoj për vëmendjen, do të jem i hapur të dëgjoj edhe kërkesat edhe nevojat e juaja, përfshirë edhe vërejtjet por edhe sugjerimet, por edhe nëse ka edhe ndonjë lavdatë me kënaqësi po e marrim.

Fjala është e juaja.

z. Mustaf Emini, nga fshati Shakovicë, theksoi, jeni për lavdata dhe ju përgëzoj për punën e mbarë. Unë kam ardhur për dy çështje në fshatin tonë e që nuk janë të mëdha. E para, kam një kërkesë të rruga që është ndërtuar te rrethi te Banja, ku me ndërtimin e saj na është mbyllur rruga e pyjeve dhe nuk kemi mundësi për transportin e druve apo diçka tjetër. Do të mjaftonte të intervenohet dhe të hapet vetëm me një eskavator, në gjatësi 500 m dhe asgjë tjetër. Çështja tjetër, kam dëgjuar se është bërë një projekt për përkthimin e tokave nga serbët. Unë kam dëgjuar se si në Shajkoc e Llapashticë kanë filluar. Unë jam prej atyre që kam ble tokën nga serbi që në kohën e Rankoviqit në vitin 1967, e shqetësimi është se po paraqiten disa matrapaz në bashkëpunim me serb për ti blerë këto toka. Në Kosovën lindore po i pasivizojnë tokat e rregullta që janë, kështu që ju përgëzoj për këtë që keni filluar, por është e nevojshme për të ardhur aty se do të ketë probleme. Ju përgëzoj edhe njëherë se vërtet keni bërë punë të shumta sa besoj se nuk keni mundur të cekni edhe ato më të imta që janë bërë. Gjithashtu ju uroj punë të mbarë në realizimin e projekteve.

z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, fillimisht ju falënderoj për fjalët që theksuat, sa i përket rrugës për shfrytëzimin e pyjeve, sa jam në dijeni traseja është bërë në atë pjesën që ka qenë e dëmtuar. Sidoqoftë nëse është nevoja ne mund të angazhojmë një bager për rregullimin e saj, ose do të kërkoj nga kompanitë që janë duke punuar për zgjatjen edhe pak të asaj traseje. Ndërsa sa i përket çështjes së projektit që është duke u realizuar për përkthimin e pronave, ky është një projekt pilot që është duke u realizuar në dy Llapashticat, Dumnicë dhe Shajkoc, pra janë katër vendbanime që është duke u realizuar prej Agjencisë Kadastrale të Kosovës-AKK dhe besoj se ky projekt pilotë do të zgjerohet edhe në lokalitet tjera në tërë territorin e Komunës sonë, por besoj se edhe në nivel vendi, por këtë vit në kuadër të projektit kanë qenë këto katër fshatra. Në të gjitha vendbanimet ka shqetësime të tilla, por besoj se do të zgjerohet si projekt. Besoj se tashmë do të marrin mostrat e këtyre pilot lokaliteteve për të parë si ka qenë procesi dhe do të zgjerohet gjithandej.

z. Hajzer Arifi, rr. "Fitorja" Podujevë, theksoi, unë kam një kërkesë, kemi hallin për ujë të pijes, jemi në gjendje shumë të rënduar edhe pse rrjetin e se kemi larg, është një km dhe rrjetin e kemi bërë ne vet qytetarët.

z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi çështja e ujit është shqetësim i të gjithë ne, jo vetëm i juaj. Qyteti i Podujevës deri tash ka pas probleme bukur shumë me furnizim me ujë të pijes. Si rezultat i kësaj ne kemi investuar në projektin e gypit fi 400 për të sjell ujin drejtpërsëdrejti në rezervuar dhe ka një javë që është vu në dispozicion ai gyp dhe tash është duke e furnizuar rezervuarin e Qytetit dhe relativisht kemi përmirësime të mira prej asaj që janë duke theksuar qytetarët veçanërisht qendra e qytetit por edhe disa pjesë tjera, si te lagja e Breçalivë, ku më përpara kanë pas shqetësim. Menaxheri i Njësisë së Auditimit më ka informuar se ka përmirësime dhe se edhe Letanci do të ketë ujë të pijes dhe sigurisht që rruga "Fitorja" lidhet në këtë gypin kryesor që shkon në drejtim të fshatit Dumnicë. Kemi përmirësuar gjendjen me ujë të pijshëm diku 80% të qytetit të Podujevës, pra ka përmirësime substanciale pozitive, por tashmë na kanë lindur dy probleme, njëri është te lagja te Radio Llapi sepse ata kanë mbetur të kyçur në gypin e vjetër të ujësjellësit dhe po paraqesin shqetësime këto ditë, ndërsa problemi tjetër na ka mbetur rruga Dumnica, që është problem edhe

furnizimi i Doganës të cilat qenkan lidhur në këtë gyp. Ne jemi duke punuar me menaxherin e Njësisë së ujës-jellësit këtu për të gjetur zgjidhje dhe unë besoj se në këtë solucion të zgjidhjes do të jetë edhe rruga "Fitorja". Jemi në dijeni se furnizimi me ujë në atë rrugë nuk është problem i sotit. Por duhet ta keni të qartë se prapë nuk do të kemi mundësi të zgjedhim problemin me ujë të pijes deri sa nuk do të arrijmë të bëjmë akumulacionin e Pollatës dhe për atë ishte angazhimi i madh i yni së bashku me Ministrinë e MPHI për të bërë akumulacionin në atë zonë, por mund të them se fatmirësisht kemi lajme të mira ku faza e fizibilitetit veç është kryer dhe po shpresojmë që të eci si projekt, sepse është projekt me kosto të lartë 60-70 milion euro, por vetëm atëherë qyteti dhe vendbanimet përreth do ta kenë të zgjedhur problemin e furnizimit me ujë të pijes, sepse me këto kapacitete që vijnë deri këtu është problematike për të shpresuar për një zgjidhje afatgjate. Mund të bëhen zgjidhje të përkohshme, por jo afatgjate. Zgjidhja afatgjate është projekti i ri i akumulacionit në Pollatë, ku përveç problemit të ujit të pijes do të zgjidhet edhe problemi i ujitjes së një pjese të tokave bujqësore. Do të interesohemi prapë në këtë çështje, të shohim se çka mund të bëjmë më shumë për të gjetur zgjidhje në rrugën e juaj atje. Ne po merremi drejtpërdrejtë me këtë punë edhe pse kjo është kompetencë e KUR Prishtina, e jo e jona si komunë. Ne mund ta ndihmojmë kompaninë diçka, apo në infrastrukturë, por nuk jemi ne përgjegjës kryesor për sigurimin e ujit të pijes, sepse sikurse e dini Ujës-jellësi është ndërmarrje publike e veçantë që duhet tu siguroj ujë qytetarëve, sepse kontrata për furnizim me ujë të pijes nuk është me komunë por me Kompaninë e ujës-jellësit, por ne jemi duke bashkëpunuar ngushtë me ta, me qëllim të zgjidhjes së këtyre problemeve që po na paraqiten. Këtë vit kemi investime të reja që do të bëhen, konkretisht në rrugën "Afrim Zhitia", rr. "Brigadat", në rrugën e Letancit, është duke u punuar në fshatin Herticë në zgjerimin e rrjetit, kështu që jemi duke punuar aq sa kemi potencial për ta shtyrë ujë si projekt përpara.

z. Nysret Restelica, nga Podujeva, theksoi, përgëzime Kryetar për punën që keni bërë. Edhe vitin e kaluar kemi qenë këtu, ndërsa para një muaji kemi ardhë këtu përfaqësues nga Restelicët, Blakçorët, Bebusht, Babatincët në takim me Ju Kryetar dhe pyetja ishte e njëjta, kur do të bëhet revidimi i Hartës Zonale të Komunës. Është premtuar se do të bëhet një komision nga juristë dhe do të kalojë në Kuvend për votim, pra edhe sot kam të njëjtën pyetje, deri ku ka shkuar procedura.

z. Ismet Zeqiri nga fshati Bellasicë, theksoi ju përgëzoj për punën që keni bërë dhe për projektet e realizuara. Nën vizoi kam tri kërkesa; Një ndër monumentet më historike në Komunën Podujevë është Kalaja e Ballasicës ose Kryelabi ose Kasovë sikurse është quajtur atëherë. Kosova e ka emrin e Bellasicës. Isha në Komunë para 3-4 viteve dhe pyeta një në Komunë kur të ju vijnë vizitorët çfarë monumentesh historike keni ju për tua prezantuar. Në vitet e 400 flitet se konsullatën Mali i Zi e ka pas në Bellasicë, ndërsa aty ka mbetur vetëm një mur që pritet të rënohet, rruga 7 km po ashtu është e mjerueshme. Aty prej kohës së Rankoviçit kush nuk ka investuar në këtë fshat, veç është shkatërruar. Ish ndërmarrja e pyjeve ka prerë pyjet, pastaj në vitet e 90 Serbia përmes Kushumlisë pa ndërprerë ka prerë pyjet në atë pjesë. Unë në Komunë më herët kam bërë kërkesë për rregullimin e kësaj rrugë, jo në kohën sa jeni Ju në qeverisje dhe më kanë thënë jo se po prehet mali, por pikërisht kur është rruga qarkullojnë edhe policia dhe kontrollojnë terrenin, ndërsa sot nuk gjen lis sa dora trashësi në pronë të shtetit. Po e përsëris kërkesa është kalanë ta merremetojmë pak. Rrymën na ka sjell Komandanti i ndjerë Mustaf Hoxha në vitet e 80-ta. Pas luftës qytetarët kanë vjedhur me shtylla dhe rrjetin përçues të rrymës dhe sot jemi pa rrymë pa rrugë dhe pa asgjë. Unë ju përgëzoj për punën që keni bërë sepse kohë më parë, para se të vini ju në qeverisje Komuna e Artanës apo Novobërdes ka qenë më e zhvilluar sesa Komuna e Podujevës, ndërsa Ju tash keni bërë punë të mrekullueshme.

z. Hashim Bujaku, Pakashiticë e Epërme, theksoi, kam një hall të vogël, njëkohësisht edhe si kërkesë, a do të mund të më vazhdoje 3-4 ditë apo një javë më së shumti afatin kohor për largimin e hekurishtës që e kam në hapësirën e Ish kooperativës në fshatin Kërpimeh, pasi që nuk po kam mundësi ta largoj brenda javës, shkaku i mungesës së punëtorëve.

z. Ruzhdi Dema, fshati Godishnjak, theksoi, fillimisht ju përgëzoj për punën e shkëlqyeshme, dua të theksoj një problem të energjisë elektrike të cilën e kemi shumë të dobët, është dyfazore dhe po na shkakton dëm, po na digjen pajisjet në shtëpi.

z. Hizri Havolli, fshati Llapashticë e Epërme, theksoi, unë kam një autolarje pran hekurudhës dhe objektit të Emergjencës dhe para disa ditësh zyrtarët komunal kanë dalë dhe kanë vendosur disa shenja për trasimin e rrugës. Shqetësimi është se ajo rrugë shihet se është fare pran autolarjes dhe pyetja është se a duhet unë të

largohem nga aty, apo a ekziston mundësia që të punojë edhe 2-3 muaj aty dhe si dëshirë e imja është që tërë jetën të kem ty kryetar.

z. Agim Osmani, Podujevë, i ndërruari Kryetar ju përgëzoi për të gjitha punët e mira që keni bërë gjatë këtij mandati, përndryshe i keni ndërruar pamjen Podujevës. Unë jam përfaqësuesi i Kompanisë së Laberionit dhe për shkak të Hartës Zonale nuk po kam mundësi të pajisem me dokumentacione adekuate si leja ujore, pëlqim mjedisor, legalizim etj. Kjo është një prej kërkesave, pasi që kam qenë edhe në Ministrinë e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe në Departamentin e ujërave dhe më kanë drejtuar në Komunën tonë. Unë jam prej lagjes së Breznicëve dhe shihet që edhe aty keni punuar. Keni shtruar një rrugë por nuk e keni shtruar komplet dhe kërkesa është për të vazhduar atë rrugë edhe për 700-800 m deri te varrezat. Unë do të mund të sjellja dëshmi se është e liruar ajo rrugë, megjithatë me ligjin e ri kadastral duhet bërë pagesa e 12-13 parcelave. Nëse ka mundësi bashkërisht me stafin e juaj për të bërë një zgjidhje, për ta bërë pronë publike. Unë edhe njëherë ju përgëzoi për punën e mirë që keni bërë sepse mund të flasim shumë për këtë dhe do ju përkrahja që të vazhdosh tutje. Kjo është punë që shihet, vetëm tani shihen 6-7 kompani të mëdha të ndërtimit duke punuar.

z. Gani Visoka, fshati Kunushec, theksoi, ju falënderoj për punën e mirëfilltë që e keni bërë deri tash. Nuk do të thotë se gjithçka mund të realizohet brenda një kohe shumë të shkurtër. Desha të potencoj dy gjëra për në fshatin Kunushec, në lagjen e Visokëve, Cubollëve dhe Reqicëve. Unë jam banor i njërës prej lagjeve dhe kemi shumë problem me mungesë të ujit dhe besoj se jeni të njoftuar. Gypi i ujit që 23 vite është i zbrazët. Nuk mund të them se gjithmonë ka qenë mungesa e ujit por është rezultat i keqpërdoruesve, e për furnizim me ujë të pijes te ne ka qenë diçka e harruar. Kemi biseduar një herë më herët së bashku dhe kam qenë edhe te Drejtori i Ujësjellësit dhe më ka thënë se jemi në bashkëpunim me Kryetarin për ndërrimin e gypit fi 400 dhe besoj se edhe juve nuk do tu lejmë pa ujë. Ne kemi hap puse deri 37m dhe jemi pa ujë. Të jesh i bindur se për ujë të pijes shkoj për tu furnizuar në Bajgorë. Mirëpo pa furnizim të mirëfilltë me ujë mund të vij edhe te ndonjë epidemi. Kërkesa është që në kuadër të mundësive të ndërmerrni diçka lidhur me këtë. Tjetër shqetësim kam vozitjen e shpejt të automjeteve që është duke u bërë në atë rrugë dhe është rrezik për këmbësorët. Kërkesa është për ndërtimin e një trotuari sepse është shumë i nevojshëm.

z. Shpejtim Bulliqi, kryetar i Komunës, theksoi, lidhur me pyetjet dhe kërkesat e paraqitura nga parafolësit, fillimisht ndaj z. Nysret Restelica rreth Hartës Zonale, ju informoj se jemi duke punuar në PZHK, konkretisht Drejtoria e Planifikimit Urban por edhe drejtoritë tjera. Jemi duke hartuar PZHK dokument i cili do t'i hap rrugë ndryshimit të Hartës Zonale. Ju bëj ftesë qytetarëve të Komunës që të bëhen pjesë e këtij procesi, të na ndihmojnë me propozime të caktuara për të bërë ndryshimet e nevojshme për të hap rrugë më pastaj ndryshimit të Hartës Zonale. Lidhur me këtë do të kemi takime publike me qytetarë dhe është mirë të marrin pjesë sa më shumë qytetarë për të dhënë ndonjë sugjerim për ndonjë ndryshim sepse sugjerimet që përfshihen tash në PZHK e që është për 8 vitet e ardhme, këto na hapin rrugë për ndryshim të Hartës Zonale, në mënyrë që ti jepet proces zhvillimit, jo vetëm qytetit por edhe fshatrave në segmente të caktuara ku ka nevojë. Prandaj po punojmë në këtë drejtim se Plani Zhvillimor Komunal është një kushtetutë e Komunës, e them kushtimisht, që ka për tu zhvilluar në 8 vitet e ardhshme, dhe rrjedhimisht me këtë e ndryshojmë edhe Hartën Zonale, pra të parashohim gjëra tjera që nuk kanë qenë të planifikuara fatkeqësisht në PZHK-në e kaluar dhe kjo do të na ndihmojë për një planifikim të mirëfilltë. Është mirë qytetarët të tregohen aktiv dhe të na përgjigjen në këto ftesa për takime publike sepse çdo propozim i juaj është i qëlluar dhe i interesit të përgjithshëm do të ndihmonte shumë. Për z. Ismet Zeqiri, Kalanë e Ballasicës e kam vizituar dhe gjendja e saj është e keqe. Këtu kam Drejtoreshën e Kulturës dhe kërkoj që këtë punë bashkërisht me Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit me vu në lëvizje në funksion të mbrojtjes së atij objekti. Vitin e kaluar kemi biseduar që t'i bëjmë një intervenim të vogël në ato mure dhe nuk jam në dijeni se deri ku ka ec procesi. Drejtoresha do të merret seriozisht me këtë çështje dhe të shohim çka mund të bëjmë. Sa i përket rrugës së Bellasicës, kemi investuar vitin e kaluar deri në Marincë, por deri ku ka shkuar nuk jam i sigurt. Por unë do të shikoj se çka është problemi i kësaj rruge dhe çka mund të bëjmë.

z. Ismet Zeqiri, theksoi monumentin historik kryesor e kemi fshatin Bellasicë. Unë nuk di në Komunë të Podujevës ku ka një monument 1600 apo 1700 vjeçar sikur Kalaja e Bellasicës. Mua më vinë në vizitë nga Zvicra kur është ndeshja e Kosovës, por mua më vije marre kur të vijnë zvicranët e të shohin atë gjendje. Pastaj edhe puna e mbeturinave, çmimi kontraktues është vetëm 5 euro, unë personalisht jam në gjendje 10

personave t'u paguaj faturat mujore për bartjen e mbeturinave. Prej Murgulle e deri në Bellasicë gjithandej rrugës sheh mbeturina të hedhura.

z. Shpejtim Bulliqi, kryetar i Komunës, theksoi, sa i përket mbeturinave, nuk është shqetësimi vetëm për atë pjesë, fatkeqësisht fjala vjen NN personi e mbush traktorin me mbeturina në Obrançë dhe shkon e hedh në vendbanim të vetin në Murgull. Ne gjithashtu kemi telashe në rrugën për Herticë, minimalisht për këto 5 vite në mandat timin 5 ose 6 here me kamionë të tërë kam larguar mbeturina dhe prapë është e njëjta gjendje. Nuk ka mundësi të ngritjes së vetëdijes tonë për 5 apo 6 euro që duhet paguar. Ne kemi filluar një proces vitin e kaluar për regjistrimin e çdo ekonomie familjare që ka orë të energjisë elektrike për ta futur në proces të pagesës edhe të mbeturinave. Ka raste që kemi dënuar me nga 100, 200 €, ndërsa ditën e premte është shqiptuar dënimi 500 € ndaj një banori në fshatin Herticë, por është e kotë. Ne vetëm të bëhemi polic dhe për të vendosur nga një person në çdo rrugë për të ruajtur se kush po hedh mbeturina. Problemi është se te ne ende nuk është ngritur ai nivel i vetëdijes që çdo njëri duhet të luaj rolin e policit sepse ai që hedh mbeturina e shkakton një dëm të përgjithshëm. Mbesim me shpresë që edhe kjo çështje do të kalohet. Sa i përket energjisë elektrike është e vërtetë se në të gjitha ato pjesë që i kemi pa banorë, fatkeqësisht pas luftës është dëmtuar shumë rrjeti i energjisë elektrike si në marrjen e shtyllave ashtu edhe të telit dhe në këtë aspekt bukur shumë ka telashe. Kemi shembullin e fshatit Përpellac ku janë disa investitor që kanë shprehur gatishmëri të kthehen dhe të investojnë por nuk mund ta bëjnë për shkak të mungesës së energjisë edhe pse dihet se përpara ka pas banim në atë pjesë por tashmë mungon rrjeti sikurse e theksova më parë. Ju e dini se KEDS si sektor është i privatizuar dhe shpërndarjen e infrastrukturës e ka kompania turke dhe kjo është një ndërmarrje që nuk na jep neve përgjegjësi. Tash jemi edhe në prag të fushatës zgjedhore dhe normal opozitarët e bëjnë punën e vet, e keni pa se shtyllat e energjisë i kanë vendosë në mes trotuareve në Podujevë. Ju garantoj se ka një vit që kam nis procedurat dhe kërkesat si institucion që të dislokojnë shtyllat nga trotuaret dhe nuk e kryejnë punën dhe shtrohet pyetja unë si institucion kur kam telashe në këtë aspekt, çfarë telashe mund të ketë qytetari, por jeni në dijeni se kjo është shitur për 23 milion euro dhe tash punët i kryejnë vet. Ne kemi Njësinë e distribuimit në Podujevë por këta nuk vendosin për shumëçka por niveli i lartë në Prishtinë dhe duhet pritur me muaj të tërë për kryerjen e një shërbimi dhe si rezultat i kësaj duhet lënë mangu trotuarin dhe nuk mund ta përmbyllim projektin për shkak të shtyllave që janë në mes trotuareve. Edhe Ormanët e orëve elektrike në vend se ti mbështesin për muri i kanë vendosur për kryq dhe komplet e kanë zënë trotuarin. Me marr masa ndaj tyre po mbesin qytetarët pa rrymë, kështu që as nuk mund ti ndjekim dhe as t'i detyrojmë. Fjala vjen po të ndërmerren masa ata i bartin investimet në rajone tjera, pra me ta duhet shikuar mundësit për të gjetur solucione si të zgjedhim problemet. Kjo përgjigje vlen edhe për z. Ruzhdi Dema në fshatin Godishnjak. Andaj juve si qytetarë ju rekomandoj që të bëni peticion, ma sjellni edhe mua një kopje dhe e protokolloni në Zyrën e KEDSIT në Podujevë me adresë Nivelit menaxhues në Prishtinë. Neve si komunë mund të na bëni vetëm presion sepse nuk kam as më të voglën kompetencë për zgjidhjen e problemit me energji elektrike, por nëse më lini një kopje të peticionit që e keni dorëzuar atje unë do të bëj përpjekje që të bëhen investime në lokalitete e juaja. Sa i përket kërkesës së z. Hashim Bunjaku për zgjatjen e afatit për largimin e hekrarisë, unë me ju kam biseduar ka gati një vit për këtë problem dhe u kam sqaruar dhe njoftuar se ky projekt do të realizohet dhe nuk është se nuk keni pas informacion sepse ju kemi dërguar edhe njoftim zyrtar për t'u dislokuar sepse ne duhet ta realizojmë projektin, ngase kjo është një punë e kontraktuar dhe kompanisë i rrjedhin afatet kohore për realizimin e projektit. Ju lutem duhet të bëni përpjekjet maksimale që sa më shpejt që është e mundur të lirohet hapësira në fjalë, sepse për aq ditë sa kjo shtyhet nga ana jote ne kemi telashe me kompaninë për realizimin e punës. Sa i përket kërkesës së z. Hizri Havolli, ne jemi duke realizuar projektin e rrugës gjatë brigjeve të hekurudhës. Rruga aktuale është shumë afër binarëve të hekurudhës dhe kemi kërkesa për ta zhvendosur dhe për ta larguar prej binarëve sepse pritet që hekurudha të rivalizohet dhe të kthehet në funksion. Për realizimin e këtij projekti kemi marr edhe një buxhet nga MMPHI, kemi të nënshkruar kontratën për realizimin e projektit dhe nuk mendoj se juve do u pengoj në zhvillimin e biznesit, sepse qëllimi ynë është që rrugën ta tërheqim më poshtë nga se është. Për kërkesën e z. Agim Osmanit, unë jam në dijeni se ka pas telashe me dokumentacion, sepse janë disa dokumentacione që edhe ne si institucione lokale patjetër se duhet respektuar. Jemi në dijeni se disa punë janë kryer më herët por nuk janë përfillë të gjitha procedurat çfarë kërkohet, sepse po të ishin përfillë atëherë procedurat ne sot s'do të kishim këto telashe. Atë që mund të ju premtoj është se do të bëjmë krejt çka është e mundur për të bërë zgjidhje sepse jeni qytetarë tanë dhe ne si autoritet komunal kemi obligime për të gjetur solucion apo zgjidhje, në kuptim të zbatimit të dispozitave ligjore. Sa i përket rrugës në lagjen Breznica

për një segment të rrugës së mbetur gjysmë kam informacione dhe besoj do ta zgjedhim këtë problem. Drejtori i urbanizmit është këtu dhe do të merret me këtë çështje, të shohim cilat janë mundësitë që ta vazhdojmë deri te varrezat. Sa i përket lagjes te visokët, lidhur me furnizimin me ujë, nuk është se ne nuk kemi punuar në këtë drejtim, jemi në kontakt me Njësinë e Ujësjellësit këtu dhe menaxheri i kësaj Njësie ka konfirmuar se jemi afër të gjetjes së problemit të furnizimit me ujë për atë pjesë. Në Penuhë kemi pas të njëjtin problem dhe sa jam në dijeni është zgjidhur problemi . Problemi i furnizimit me ujë të pijshëm në rrugën “ Fitorja “ është duke u testuar dh nëse nuk do të ketë zgjidhje me zgjedhjen e fundit që është bërë atëherë, atëherë duhet bërë disa pompa për të pasur mundësi të furnizimit me ujë të mjaftueshëm atë pjesë. Për çështjen e trotuarit do të angazhohet edhe Drejtori i Shërbimeve Publike dhe të njëjtin do ta parashohim si projekt.

z. Hilmi Kiçmari, me vendbanim në Podujevë, theksoi, fillimisht do të përgëzoja Kryetarin e Komunës, Nënkryetaren dhe Drejtorët e Drejtorive për punën që kanë bërë gjatë këtyre viteve. Është një punë e merituar dhe shumë e mirë. Unë kam ardhur me disa shqetësime, të vogla ndoshta për ju por neve po na nxjerrin kokëçarje. E para është se në atë rrugë ka frekuentim të veturave bukur shumë dhe faktikisht po kemi shumë telashe sepse kur fëmijët po dalin po kemi shumë problem. Kërkesa është për vendosjen e dy pengesave të vogla. Fjala është për rrugën “ Hakif Sheholli, ish Albaniku, te Radio Llapi. Në pjesën ku unë banoj , pran rezervuarit të ujit gjendja është shumë e keqe për shkak të hedhjes së mbeturinave. Çështje tjetër është se ajo rrugë që nga viti 2004 kur është ndërtuar nuk ka trotuar, ne fatmirësisht po ndëtojmë trotuare nëpër fshatra të largëta ku frekuentimi i fëmijëve është më i vogël sesa këtu në qendër, pra është shumë problem edhe për fëmijët që lëvizin për në shkollë por edhe për të tjerët. Rruga nuk ka më shumë se 600-700 m. Ka nevojë për një trotuar të vogël, ose të bëhen disa pengesa në rrugë se me të vërtetë po kemi problem. Problem tjetër kemi furnizimin me ujë edhe pse jemi fare pranë rezervarit të ujit. Unë personalisht kam bërë një zgjidhje me hapjen e një pusi por të tjerët kanë telashe. Kështu që kërkesa është që të na bëni zgjidhje me furnizim me ujë të pijshëm dhe rregullimin e një trotuari dhe ndonjë pengesë në rrugë. Për këto që përmenda kam bërë kërkesë në Drejtorinë e Shërbimeve Publike , por Drejtori më pat thënë që duhet të bisedoj me Kryetarin. Edhe njëherë ju përgëzoj për punën.

z. Avdyll Azemi, theksoi, ne kemi një kërkesë, bëhet fjalë për rrugën “ Maliq Dabinovci. Çështja është se tash që po i shtrojnë rrugët nëpër oborre të shtëpive, ka ardhur Kompania Musliu ka gërrye dhe e ka bërë të gatshëm për asfalt por ka dy javë që ka lënë kamionët dhe bagerat aty. Unë e mora në tel dhe më tha se në atë rrugë duhet të hiqet zhavorri sepse jena pa projekt, gjoja se ka ndodh një gabim. Unë kam fotografua të gjitha në çfarë gjendje e ka bërë dhe mua më ka dëmtua me kablo dhe murin dhe problemi është se nuk janë duke ardhur për të vazhduar me rregullimin rrugës, për të cilën sikurse ju jeni në dijeni kam aplikuar ka 4 vite. Për në fund ju uroj punë të mbarë, përndryshe jeni më i miri.

z. Shpejtim Bulliqi, kryetar i Komunës, theksoi, nuk ka shqetësim për atë rrugë, sepse ajo do të rregullohet. **znj. Antigonë Ejupi**, Sekiracë, theksoi, në Sekiracë nuk ke pse del në oborr në orët e mbrëmjes për shkak të kundërmimit të lumit Llap. Nuk jam në dijeni se a ka ndonjë kërkesë prej ndokujt apo çfarë duhet ndërmarr aty.

z. Shpejtim Bulliqi, kryetar i Komunës, theksoi, tashmë më informoi Drejtori i Drejtorisë së Inspeksionit se qenka një fermë pranë me mbi 150 krerë lopë, e cila është duke e keqpërdor duke derdhur ujin e fermës në lumin Llap duke bërë ndotjen e lumit. Sipas informacionit fermeri është dënuar nga inspeksioni, dhe çështja e asaj ferme ka shkuar edhe në Nivel qendror dhe ne duhet ta zgjidhim atë problem.

Muhamet Gubetini Podujevë, theksoi kam një shqetësim, rruga “Edi Durham”, është degëzim i rrugës “ Dëshmorët Babatinca”, problemi është se kanalizimi në 200 m e fundit është shumë i lartë dhe është problem kyçja në kanalizim, pastaj po ashtu edhe kundërmon shumë ajo pjesë.

z. Fadil Berisha, Kunushec, theksoi, gjithashtu unë i bashkëngjitëm mendimeve të pjesëmarrësve këtu në takim se është bërë një punë shumë e mirë në Komunën tonë nën udhëheqjen e Kryetarit . Në fshatin Kunushec i kemi pas tri kërkesa, njëra ka qenë asfaltimi i rrugës deri te lagja Deda rreth 500 m, e pasë në projekte të paraqitura për asfaltim në fshatin Konushec, por nuk e di se për ku ishte fjala sepse nuk ishte e apostrofuar. Po ashtu edhe dy kërkesa kanë qenë për trotuare për dy rrugica me gjatësi prej 70m.

z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, do të dërgojë një ekip nga Komuna për të parë gjendjen në rrugën “Edi Durham” për të parë gjendjen dhe të shohim çfarë zgjidhje mund t'i japim. Sa i përket kërkesave të z. Hilmi Kiçmari, për ujin duhet të punojmë bashkë me kompaninë e Ujësjellësit për të parë se si mund të bëjmë zgjidhje, për çështjen e mbeturinave do të merremi menjëherë gjatë ditës dhe do t'i japim zgjidhje këtij

problemi. Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike do të merret edhe me çështjen e trotuarit dhe pengesave, të shohim si mund të bëjmë zgjidhje. Sa i përket vozitjes së shpejt dhe rrezikimit të këmbësorëve është mirë edhe në Polici të bëni një peticion.

z. Halit Dema Podujevë, theksoi kam një kërkesë për rregullimin e rrugës Neodardania, sepse është prerë dhe dëmtuar nga KEDS , prej kur kanë bërë shtrirjen e rrjetit të ri të energjisë elektrike. Rruga është në gjatësi rreth 800 m. Problem tjetër sikur se u përmend më herët është furnizimi me ujë. Ne prej vitit 1983 kemi rrjetin e furnizimit me ujë dhe asnjëherë nuk na është ndal uji, ndërsa tash po na ndalet.

z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, problemin e ujit me atë lagje të cekur nga parafolësi, jemi të informuar se ka telashe. Sikurse e përmenda më herët ajo lagje ka mbetur bashkë me rrugën “ Fitorja” në Dumnicë dhe Dogana te kufiri, këto kanë mbetur në gypin e vjetër fi 260 që ka qenë funksional deri tash dhe kjo lagje përpara nuk ka pas telashe dmth ka pas ujë 24 orë pa ndërpre , kur të tjerëve u ka munguar këta kurrë s’kanë pas mungesë. Tash ka kaluar gypi 400 për furnizim të qytetit, ndërsa në gypin e vjetër furnizon edhe fshatrat prej Shajkoci dhe e sjell ujin deri këtu. Fshatrat gjatë verës gjithsesi e keqpërdorin ujin dhe sasia e ujit që vjen në qytet është më e vogël gjatë kësaj periudhe kohore të nxehtë. Kemi diskutuar me menaxherin e Kompanisë për t’ua ndal fshatrave kyçjet në mënyrë që ky gyp të furnizohet dhe të ketë ujë mjaftueshëm kjo lagje dhe janë duke punuar në këtë drejtim. Këtë e kam paraqit si shqetësim edhe në Nivel qendror në KUR Prishtina dhe ditën e premte më kanë njoftuar se janë marr seriozisht me këtë problem dhe pres që të ketë rezultat kjo punë. Nëse nuk bëhet zgjidhje duhet gjetur solucion tjetër alternativ çfarë mund të bëjmë, në mënyrë që mos ketë telashe kjo lagje.

z. Hilmi Kijmari, theksoi, a mund të vendoset një pllakë komunale për ndalimin e hedhjes së mbeturinave në pjesën ku e përmenda më herët pran rezervuarit të ujit të qytetit.

z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi atë pjesë do ta pastrojmë menjëherë nga mbeturinat dhe do të vendosim shenjën, por sikurse theksoi më herët bashkatdhetari z. Ismet Zeqiri, merrni rolin aktiv çdo njëri , s’po them të policit por të qytetarit aktiv dhe kur shihen këto keqpërdorime dhe shkelje të fotografohen dhe të raportohen. Unë kam detyruar inspektorët komunal kanë shkuar dhe kanë kontrolluar mbeturinat që kanë hedhur dhe është hasur në një libër me emër të një nxënësi dhe me atë libër kemi shkuar në Gjimnaz, është identifikuar nxënësi dhe familjarit i është dhënë dënimi nga ana e inspeksionit. Kështu që ju lutem na ndihmoni sepse ne nuk kemi aq shumë inspektorë për të mbuluar njëkohësisht çdo cep të Podujevës. Fjala vjen nëse ti ma dërgon ndonjë foto të ndonjë personi duke hedhur mbeturina, sikurse patëm rastin të një personi që është fotografuar duke hedhur mbeturina në Lumin Llap , është dënuar 500 €. Edhe ju kur e shihni ndonjë personin duke hedhur mbeturina, apo duke marr shtyllën e rrjetit elektrik apo duke marr telin pse mos t’i bëni një foto dhe të na njoftoni, ne pastaj marrim masat adekuate ligjore. Kjo është pasuri e përgjithshme e jona dhe ne përdorisim nuk vetëdijesohemi për ti ndjekur të gjitha këto probleme, ku çdo njëri të bëhet qytetar aktiv jo polic ne gjithmonë do ti kemi këto probleme . Nuk ka logjikë, pse të tolerohet kur personi fjala vjen mbushë rimorkion me mbeturina dhe niset prej Podujeve dhe e dërgon në Herticë e ti qytetar i Herticës po tregohesh pasiv dhe s’po i bën një fotografi. Duhet ti bëni fotografi sepse i ndihmoni vetes së pari por na ndihmoni edhe neve si institucione. Prandaj një fotografi nuk të kushton asgjë ty por na ndihmon neve por edhe atij komuniteti, sepse kur të merr një dënim 500 € sigurisht se kjo do të ketë efekt sepse e mendon mirë të hedh mbeturina apo jo, apo për të shkuar për të bërë pagesën prej 5 € në muaj për bartje të mbeturinave.

z. Halit Dema, Podujevë, shprehu kërkesën për rregullimin e një shakti në rrugën “Neodardania “.

z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, kërkesa e shtruar nga Dema besoj se do të rregullohet. Kryetari e përmbylli takimin duke i falënderuar të gjithë për pjesëmarrje dhe kontributin.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00

**Procesverbalin e mbajti
Sabedin Namani**

**Nr.Proc.02-060/04-0036595/25
Podujevë, datë:30.06.2025**

